

# PHILIPS

Boks SoundBar

7000 series

TAB7305

# Manuali i përdorimit



Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

|          |   |           |
|----------|---|-----------|
| <b>1</b> | <b>E rëndësishme</b>                              | <b>2</b>  |
|          | Ndihmë dhe mbështetje                             | 2         |
|          | Udhëzime të rëndësishme sigurie                   | 2         |
|          | Kujdesi për produktin tuaj                        | 4         |
|          | Kujdesi për mjedisin                              | 4         |
|          | Pajtueshmëria                                     | 4         |
|          | Çfarë ka në kuti                                  | 5         |
| <b>2</b> | <b>Soundbar juaj</b>                              | <b>6</b>  |
|          | Njësia kryesore                                   | 6         |
|          | Subwoofer me valë                                 | 6         |
|          | Konektorët  | 7         |
|          | Telekomanda                                       | 7         |
|          | Përgatitja e telekomandës                         | 8         |
| <b>3</b> | <b>Lidhja</b>                                     | <b>9</b>  |
|          | Vendosja  | 9         |
|          | Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera | 10        |
| <b>4</b> | <b>Përdorimi i SoundBar</b>                       | <b>12</b> |
|          | Ndezja dhe fikja                                  | 12        |
|          | Gjendje pritjeje automatike                       | 12        |
|          | Zgjedhja e modaliteteve                           | 12        |
|          | Zgjidhni efektin e ekualizuesit (EQ)              | 12        |
|          | Rregulloni volumin                                | 13        |
|          | Punimi me Bluetooth                               | 13        |
|          | Punimi me USB                                     | 14        |
|          | Parametrat standarde të fabrikës                  | 14        |
| <b>5</b> | <b>Montimi në mur</b>                             | <b>14</b> |
| <b>6</b> | <b>Të dhënat e produktit</b>                      | <b>15</b> |
| <b>7</b> | <b>Zgjidhja e problemeve</b>                      | <b>16</b> |

# 1 E rëndësishme

Lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Garancia nuk është e vlefshme nëse dëmtimi shkaktohet nga mosndjekja e udhëzimeve.

## Ndihmë dhe mbështetje

Për mbështetje intensive online, vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support) to:

- shkarkoni manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shpejtë
- shikoni udhëzuesin me video (të disponueshme vetëm për disa modele)
- gjeni përgjigje për pyetje të bëra shpesh (FAQ)
- na dërgoni pyetje me email
- bisedoni me përfaqësuesit tanë.

Ndiqni udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit.

Ose mund të kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serisë së produktit. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

## Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Lexoni këto udhëzime.
- Ruajini këto udhëzime.
- Përmbajuni të gjitha paralajmërimeve.
- Ndiqni të gjitha udhëzimet.
- Mos e përdorni këtë pajisje pranë ujit.
- Pastrojini vetëm me leckë të thatë.
- Mos i bllokoni hapësirat e ajrimit. Instalojeni sipas udhëzimeve të prodhuesit.

- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie, si për shembull pranë radiatorëve, rrugëdaljeve të ngrohjes, sobave ose pajisjeve të tjera (duke përfshirë amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Mos e anashkaloni qëllimin e sigurisë së spinës së polarizuar ose me tokëzim. Një spinë e polarizuar ka dy kunjat ku njëra prej tyre është më e gjerë se tjetra. Një spinë me tokëzim ka dy kunjat dhe një tjetër për tokëzimin. Kunja më e gjerë ose kunjat e tretë është për sigurinë tuaj. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektrikist për të ndërruar prizën.
- Mbrojeni kordonin e energjisë në mënyrë që të mos shkelet ose kafshohet, sidomos pranë spinave, prizave dhe në pikën ku dalin nga pajisja.
- Përdorni vetëm shtesa/aksesorë të specifikuar nga prodhuesi
- Përdoreni vetëm me karrocë, mbajtëse, tripod, kllapë ose tavolinë të specifikuar nga prodhuesi, ose që shitet bashkë me pajisjen. Kur përdoret karrocë, bëni kujdes kur lëvizni karrocën bashkë me aparatit për të mos rrezikuar që ta rrëzoni.
- Shkëputeni këtë pajisje nga priza gjatë stuhive me vetëtimat ose kur nuk përdoret për kohë të gjatë.
- Të gjitha riparimet duhet të bëhen nga personat e kualifikuar të servisit. Riparimet duhen bërë kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kur kordoni i energjisë ose spina është dëmtuar, kur janë derdhur lëngje ose kanë rënë objekte brenda pajisjes, kur pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, kur nuk punon normalisht ose kur është rrëzuar.



- KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të aparatit:
  - Montojini të gjitha bateritë si duhet, + dhe -siç janë shënuar në aparat.
  - Mos i bashkoni bateritë (të vjetrat me të reja, ose bateritë e karbonit me ato alkaline, etj.).
  - Hiqini bateritë kur aparati nuk përdoret për kohë të gjatë.
  - Bateritë nuk duhet të ekspozohen ndaj dritës direkte të diellit, zjarrit ose burimeve të ngjashme të nxehtësisë.
  - Material perklorati - mund të jetë e nevojshme të trajtohet në mënyrë të veçantë. Shikoni [www.dtsc.ca.gov/hazardouswaste/perchlorate](http://www.dtsc.ca.gov/hazardouswaste/perchlorate).
- Produkti/telekomanda mund të ketë një bateri të tipit monedhë/kopsë, e cila mund të gëlltitet padashur. Mbajeni gjithnjë larg nga fëmijët! Nëse gëlltitet, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin djegie të rënda brenda dy orësh pas gëlltitjes.
- Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajeni gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterisë të jetë krejt i sigurt pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterisë nuk mund të sigurohet komplet, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontakti prodhuesin.
- Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi pajisje (për shembull, objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Ky aparat mund të përmbajë plumb dhe mërkur. Hidheni sipas ligjeve vendëse, shtetërore dhe federale. Për informacione lidhur me hedhjen ose riciklimin, ju lutemi kontaktoni autoritetet lokale. Për ndihmë të mëtejshme lidhur me opsionet e riciklimit, ju lutemi kontaktoni [www.mygreenelectronics.com](http://www.mygreenelectronics.com) ose [www.eiae.org](http://www.eiae.org) ose [www.recycle.philips.com](http://www.recycle.philips.com).
- Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Mos e vendosni këtë aparat mbi mobilie që mund të anohen nga një fëmijë ose një i rritur kur mbështetet, e tërheq, qëndron në këmbë ose hip sipër tyre. Nëse aparati bie, mund të shkaktojë lëndime të rënda ose madje vdekje.
- Ky aparat nuk duhet të vendoset në një instalim të brendshëm si për shembull në dollap librash ose në raft, përveç nëse ka ajrim të mirë. Sigurohuni që të lini hapësirë prej 20 cm ose më shumë anembanë këtij aparati.

### Simboli i pajisjes Klasi II



Ky simbol tregon se aparati ka sistem izolimi të dyfishtë.

### Njihuni me këto simbole sigurie



Kjo 'shenjë rufeje' tregon se brenda pajisjes ka material të paizoluar, i cili mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, ju lutemi mos e hiqni kapakun.



"Pikëçuditja" tërheq vëmendjen për veçori, për të cilat duhet të lexoni literaturën e bashkëngjitur me qëllim që të parandalohen problemet e operimit dhe mirëmbajtjes.

**PARALAJMËRIM:** Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, ky aparat nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, dhe objektet me lëngje, siç mund të jenë vazot nuk duhen vendosur mbi këtë aparat.

**KUJDES:** Për të parandaluar goditjet elektrike, puthiteni kunjën e gjerë të spinës me vrimën e gjerë, dhe futeni plotësisht.

---

## Kujdesi për produktin tuaj

Përdorni leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

---

## Kujdesi për mjedisin

**Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive**



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri të brendshme që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU e cila nuk mund të hidhet së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

---

## Pajtueshmëria


Ky produkt i përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio.

Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në [www.p4c.philips.com](http://www.p4c.philips.com).

## Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe shikoni çfarë ka në kuti:

- Soundbar x1
- Subwoofer me valë x1
- Telekomanda x1
- Kordoni i energjisë (për Subwoofer) \* x2
- Kordoni i energjisë (për Soundbar)\* x2
- Kit për montimin në mur x1  
(Kllapa muri x2, vida x2, upa x2)
- Manuali i përdorimit/Garancia mbarëbotërore/Fleta e sigurisë x 1



Subwoofer me valë



Telekomanda



Kordoni i energjisë  
2X



Kordoni i energjisë 2X



Vida/  
Kapak



Kllapa e murit



Garancia  
mbarëbotërore



Manuali i përdorimit



Dokumenti i të dhënave të sigurisë


\* Sasia e kordonit të energjisë dhe lloji i spinës mund të ndryshojë sipas zonave.

## 2 Soundbar juaj

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni SoundBar në [www.philips.com/welcome](http://www.philips.com/welcome).

### Njësia kryesore


Kjo pjesë përmban një përmbledhje të njësive kryesore.



- ① **POWER**  
Ndizeni ose fikeni Soundbar.
- ② **SOURCE**  
Zgjidhni një burim për Soundbar.
- ③ **VOL +/-**  
Rritja/ulja e volumit.
- ④ **Treguesit LED**

### Subwoofer me valë


Kjo pjesë përmban një përmbledhje të Subwoofer me valë.



- ① **AC~ Priza**  
Lidhja me energjinë.
- ② **Butoni i çiftimit**  
Shtypni për të hyrë në modalitetin e bashkimit për Subwoofer.
- ③ **Treguesi i Subwoofer**
  - Kur është i ndezur, treguesi ndizet.
  - Gjatë lidhjes me valë mes Subwoofer dhe njësive kryesore, treguesi LED pulson me ngadalë në ngjyrë portokalli.
  - Kur çiftimi bëhet me sukses, treguesi qëndron pa lëvizur.
  - Kur çiftimi dështon, treguesi pulson shpejt në ngjyrë portokalli.
  - Kur njësia kryesore fiket ose kalon në gjendjen në pritje, treguesi LED fiket.

## Konektorët


Kjo pjesë përmban një përmbledhje të konektorëve të disponueshëm në Soundbar dhe Subwoofer.



- ① **USB**  
Hyrja audio nga një pajisje memorieje USB.
- ② **HDMI OUT (ARC)**  
Lidhuni me hyrjen HDMI në televizor.
- ③ **OPTICAL**  
Lidhuni me një dalje audio optike në televizor ose në një pajisje digjitale.
- ④ **AUX**  
Hyrja e audios nga një pajisje e jashtme, si televizor, aparat MP3, telefon celular, tabletë, etj.
- ⑤ **AC~ Priza**  
Lidhni energjinë.

## Telekomanda

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të telekomandës.





- ① **⏻ (POWER)**  
Ndizeni ose fikeni Soundbar.
- ② **⏻ (MUTE)**  
Heshtni ose riktheni volumnin.
- ③ **HDMI ARC**  
Kalojeni burimin e te lidhja HDMI ARC.
- ④ **AUX**  
Kalojeni burimin e audios në lidhjen AUX (xheku 3.5mm).
- ⑤ **Pair/BT**  
Kaloni në modalitetin Bluetooth. Shtypeni dhe mbajeni shtypur për të aktivizuar funksionin e lidhjes në modalitetin Bluetooth ose shkëputni pajisjen Bluetooth ekzistuese të lidhur.
- ⑥ **OPTICAL**  
Kalojeni burimin e audios te lidhja optike.
- ⑦ **USB**  
Kaloni në modalitetin USB.
- ⑧ **EQ**  
Zgjidhni efektin e ekualizuesit (EQ).
- ⑨ **▶|| (PLAY/PAUSE)**  
Filloni, ndaloni ose vazhdoni luajtjen në modalitetin BT/USB.
- ⑩ **⏮ ⏭ (PREVIOUS/NEXT)**  
Kaloni te kënga e mëparshme ose te kënga tjetër në modalitetin BT/USB.
- ⑪ **🔊 VOL +/- (Volumi i Soundbar)**  
Rritni ose ulni volumnin.
- ⑫ **🔊 (+/-) +/- (Volumi i Subwoofer)**  
Rriteni ose uleni volumnin e Subwoofer.


## Përgatitja e telekomandës

- Telekomanda e dhënë bën të mundur që ta përdorni pajisjen nga njëfarë distance.
- Edhe nëse telekomanda përdoret brenda distancës efektive prej 6 m, përdorimi i telekomandës mund të mos jetë i mundur nëse ka pengesa mes aparatit dhe telekomandës.
- Nëse telekomanda përdoret pranë produkteve të tjera që gjenerojnë rreze infrared, ose nëse pranë aparatit përdoren telekomanda të tjera me infrared, ajo mund të mos punojë si duhet. Përndryshe, produktet e tjera mund të mos punojnë si duhet.

## Përdorimi për herë të parë:

Aparati ka një bateri litiumi të montuar paraprakisht.

Hiqeni veshjen mbrojtëse për të aktivizuar baterinë e telekomandës.




## Ndërrojeni baterinë e telekomandës

Telekomanda ka nevojë për një bateri litiumi 3V CR2025.

- 1 Përdorni mjete (si bateri monedhë/ monedha) për ta kapur zgavrën e kapakut të baterisë dhe rrotullojeni në drejtim të kundërt të akrepave për ta hapur.
- 2 Hiqeni baterinë e vjetër, e cila ndodhet në kapak, vendosni baterinë e re CR2025 dhe kushtojini vëmendje polaritetit të duhur (+/-).

- 3 Përdorni mjetet për ta kapur zgavrën e pjesës së baterive dhe rrotullojeni në drejtim të akrepave të orës për ta (kyçur) fiksuar në telekomandë.



## Masa paraprake lidhur me bateritë

- Kur telekomanda nuk do të përdoret për kohë të gjatë (më shumë se një muaj), hiqeni baterinë nga telekomanda për të mos e lejuar që të rrjedhë.
- Nëse bateritë rrjedhin, pastrojini pjesën e derdhur brenda vendit të baterisë dhe ndërrojini bateritë me të reja.
- Mos përdorni bateri të tjera përveç atyre që janë specifikuar.
- Mos i nxehti ose çmontoni bateritë.
- Asnjëherë mos i hidhni në zjarr ose në ujë.
- Mos i mbani ose mos i ruani bateritë bashkë me objekte të tjera metalike. Kjo mund të bëjë që bateritë të krijojnë qark të shkurtër ose të pëlcasin.
- Asnjëherë mos e karikoni një bateri përveç nëse është konfirmuar se është bateri e karikueshme.

## 3 Lidhja

Kjo pjesë ju ndihmon që ta lidhni Soundbar me një televizor ose me pajisje të tjera. Për informacion rreth lidhjeve bazë të SoundBar dhe aksesoreve, shikoni udhëzuesin e shpejtë.


### Shënim

- Për identifikimin dhe të dhënat për energjinë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë të shkëputura nga priza.

## Vendosja

Vendoseni Subwoofer të paktën 1 metër larg nga SoundBar, dhe dhjetë centimetra larg murit.

Për të pasur rezultatet më të mira, vendoseni Subwoofer siç tregohet më poshtë.




# Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera

## Lidhuni me portën HDMI (ARC)

Disa televizorë 4K HDR kërkojnë që hyrja HDMI ose cilësimet e figurës të konfigurohen për marrjen e materialit HDR. Për hollësi të mëtejshme konfigurimi lidhur me HDR, ju lutemi shikoni manualin e udhëzimeve të televizorit.

SoundBar mbështet HDMI me Audio Return Channel (ARC). Nëse televizori juaj është i pajtueshëm me HDMI ARC, mund ta dëgjoni audion e televizorit nëpërmjet SoundBar duke përdorur një kablul HDMI të vetëm.




- 1 Duke përdorur një kabllo High Speed HDMI (nuk është i përfshirë), lidhni konektorin **HDMI OUT (ARC)** në Soundbar tuaj me konektorin HDMI ARC në televizor. Konektori HDMI ARC në televizor mund të jetë emërtuar ndryshe. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.
- 2 Në televizor, aktivizoni veprimet HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.

## Shënim

1. Televizori duhet të mbështetë funksionin HDMI-CEC dhe ARC. HDMI-CEC dhe ARC duhet të jenë të aktivizuara.
2. Mënyra e konfigurimit të HDMI-CEC dhe ARC mund të ndryshojnë në varësi të televizorit. Për hollësi rreth funksionit ARC, ju lutem shikoni manualin e përdorimit të televizorit.
3. Vetëm kabllo e pajtueshëm me HDMI 1.4 mund të mbështetin funksionin ARC.

## Lidhja me një prizë optike




Duke përdorur një kabllo optike (nuk është përfshirë), lidhni konektorin **OPTICAL** në Soundbar tuaj me konektorin **OPTICAL OUT** në televizor ose në pajisje të tjera.


- Konektori optik digital mund të jetë emërtuar **SPDIF** ose **SPDIF OUT**.

## Lidhja me një prizë AUX


- Përdorni një kablul audio 3,5 mm me 3,5 mm (nuk është përfshirë) për të lidhur portën e kufjes së televizorit me portën AUX në pajisje.



- Përdorni kablul RCA me 3,5 mm (nuk është përfshirë) për të lidhur portat e daljes audio të televizorit me portën AUX në pajisje.



- Përdorni një kablo audio 3,5 mm me 3,5 mm (nuk është i përfshirë) për të lidhur pajisjet e jashtme, si për shembull një aparat MP3, një telefon celular ose tabletë, etj.



## Lidhja me energjinë

- Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që të keni bërë të gjitha lidhjet e tjera.
- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë pajisjes.
- Lidhni kabllon e energjisë AC~ të pajisjes dhe më pas lidhni me prizën elektrike.
- Lidhni kabllon e energjisë në prizën AC~ të subwoofer dhe më pas lidhni në një prizë elektrike.
- Sasia e kordonit të energjisë dhe lloji i spinës mund të ndryshojë sipas zonave.

## Lidhja me Subwoofer

### Lidhja automatike

Lidhni Soundbar me Subwoofer në prizat e energjisë dhe më pas shtypni mbi aparat ose telekomandë për ta **ndezur** pajisjen. Subwoofer dhe SoundBar do të lidhen automatikisht.

### Këshilla

- Mos shtypni **Pair** mbrapa Subwoofer, përveçse për të bërë çiftimin manual.

### Lidhja manuale

Nëse nuk mund të dëgjohet audio nga Subwoofer me valë, lidhni manualisht Subwoofer.

- 1 Mbani shtypur **Source & Vol-** (Source & Vol-) njëkohësisht në Soundbar, dhe më pas mbani shtypur butonin Pair në subwoofer.
  - ↳ Treguesi AUX/USB në Soundbar dhe treguesi Pair në subwoofer do të pulsojnë me ngadalë. Subwoofer do të çiftohet me sukses për rreth 2 sekonda.
- 2 Treguesi AUX/USB fiket, treguesi LED i çiftimit të subwoofer rritet konstant kur lidhja bëhet me sukses.
- 3 Nëse lidhja manuale dështon dhe treguesi Pair vazhdon të pulsojë, përsëritni hapin 1.

### Këshilla

- Subwoofer duhet të jetë jo më shumë se 6 m larg Soundbar në një vend të hapur (sa më afër aq më mirë).
- Hiqni çdo objekt mes Subwoofer dhe Soundbar.
- Nëse lidhja me valë dështon përsëri, kontrolloni nëse ka ndonjë konflikt ose interferencë të fortë (p.sh. interferencë nga një pajisje elektronike) pranë vendit. Hiqini këto konflikte ose interferenca të forta dhe përsëritni procedurat e mësipërme.

# 4 Përdorimi i SoundBar

Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni SoundBar për të luajtur audio nga pajisjet e lidhura.


## Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme të treguara në udhëzuesin e shpejtë dhe në manualin e përdorimit.
- Kalojeni SoundBar te burimi i duhur për pajisjet e tjera.

## Ndezja dhe fikja

- Kur e lidhni pajisjen në prizë, pajisja do të jetë në gjendje STANDBY. Treguesi STANDBY do të ndizet në ngjyrë të kuqe.

## Standby ON

| Gjendja e sistemit  | Standby On  |
|---------------------|---|
| Treguesi Aktiviteti |  |

- Shtypni butonin **⏻ (POWER)** në pajisje ose telekomandën për ta ndezur ose fikur pajisjen.
- Shtypni butonin **↻ (SOURCE)** një herë në pajisje ose shtypni cilindo buton Source në telekomandë për ta zgjuar pajisjen.
- Hiqeni spinën nga priza nëse doni ta fikni pajisjen komplet.


## Gjendje pritjeje automatike

Njësia kalon automatikisht në gjendje pritjeje pas 15 minutash nëse televizori ose njësia e jashtme shkëputet ose fiket.






- Për ta fikur pajisjen komplet, hiqeni spinën nga priza.
- Ju lutemi fikeni pajisjen komplet për të kursyer energji kur nuk e përdorni.

## Zgjedhja e modaliteteve

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin **↻ (Source)** në pajisje ose shtypni butonin përkatës në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **AUX, OPTICAL, HDMI ARC, BT, USB**.
- 2 Drita treguese në Soundbar do të tregojë se cili modalitet është duke u përdorur.



## Burimi i hyrjes

| Gjendja e sistemit  | AUX  | USB  | BT   | OPTICAL  | HDMI ARC  |
|---------------------|--|--|--|--|---|
| Treguesi Aktiviteti |  |  |  |  |  |

## Zgjidhni efektin e ekualizuesit (EQ)

Vendosni modalitete zëri të caktuara paraprakisht për t'iu përshtatur videos ose muzikës tuaj.

Shtypni butonin **EQ** në telekomandë për të zgjedhur efektet që doni të ekualizuesit:

- ↳ Dritat LED pulsojnë për 3 sekonda për të treguar modalitetin EQ aktual sipas modalitetit EQ të zgjedhur.

## Ekualizuesi (EQ)

| Gjendja e sistemit  | Film | Muzikë | Lajme |
|---------------------|------|--------|-------|
| Treguesi Aktiviteti |      |        |       |

### Film/Muzikë/Lajme

- **Film** -për shikimin e filmave
- **Muzikë** -për dëgjimin e muzikës
- **Lajme** -për dëgjimin e lajmeve


## Rregulloni volumin

Shtypni **Vol+/Vol-** (**Volumi**) për ta rritur ose ulur nivelin e volumit.

- Për ta heshtur zërin, shtypni **Mute**.
- Për ta rikthyer zërin, shtypni cilindo prej butonave ose bëni ndonjë veprim.




### Volumi i Soundbar



### Ndryshimi i volumit të Subwoofer

Shtypni butonin **(\*)** +/- për të rregulluar volumin e subwoofer.

### Volumi i subwoofer



## Punimi me Bluetooth

Duke përdorur Bluetooth, lidheni SoundBar me pajisjen Bluetooth (si iPad, iPhone, iPod touch, telefon Android, ose laptop), dhe më pas mund të dëgjoni skedarët audio të ruajtur në pajisje me anë të bokseve SoundBar.

### Çfarë ju duhet

- Një pajisje Bluetooth që mbështet profilin Bluetooth A2DP, AVRCP dhe me Bluetooth versioni 4.2 + EDR.
- Distanca funksionale maksimale mes SoundBar dhe një pajisjeje Bluetooth është rreth 10 metra.



### Gjendja e Bluetooth

| Gjendja e sistemit  | Hyni në modalitetin BT | Duke u çiftuar | U çiftua |
|---------------------|------------------------|----------------|----------|
| Treguesi Aktiviteti |                        |                |          |


- 1 Shtypni vazhdimisht butonin në pajisje ose shtypni butonin **Pair/BT** në telekomandë për ta kaluar Soundbar në modalitetin Bluetooth.  
↳ Treguesi i Soundbar pulson në ngjyrë të bardhë.
- 2 Mbani shtypur butonin në pajisje ose mbani shtypur butonin **Pair/BT** në telekomandë për të hyrë në modalitetin e çiftimit. Mbani shtypur & + (source & vol+), pajisjet e çiftuara më parë do të fshihen dhe Soundbar hyn përsëri në modalitetin e çiftimit.  
↳ Treguesi i Soundbar pulson në ngjyrë të bardhë.

- 3 Në pajisjen Bluetooth, ndizni Bluetooth, kërkoni dhe zgjidhni **Philips TAB7305** për të filluar lidhjen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes Bluetooth për mënyrën se si të aktivizoni Bluetooth).
- 4 Prisni derisa treguesi i Soundbar të bëhet i bardhë solid.
- 5 Për të dalë nga Bluetooth, kalojeni pajisjen në një burim tjetër. Kur e riktheheni në modalitetin Bluetooth, lidhja Bluetooth qëndron aktive.
- 6 Nëse doni të lidheni me një pajisje tjetër, mbani shtypur butonin **↻** në Soundbar ose butonin **Pair/BT** në telekomandë për ta shkëputur pajisjen e lidhur aktualisht e për të hyrë në modalitetin e çiftimit.

## Punimi me USB

Mund të luani skedarë muzikorë që janë ruajtur në një pajisje USB të lidhur. Për skedarët që mund të luhen, shikoni "formatet audio që mbështeten" në faqen 15.

Kujdes: Priza USB nuk mund t'i karikojë pajisje.



## Parametrat standarde të fabrikës

Kur pajisja është e ndezur, mbani shtypur **VOL + & VOL -**, të gjitha dritat LED të pajisjes ndizen për 5 sekonda dhe pajisja rivendoset në gjendjen e fabrikës.


# 5 Montimi në mur

## Shënimi

- Montimi i papërshtatshëm në mur mund të shkaktojë aksidente lëndime ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje kontaktoni shërbimin e kujdesit ndaj klientit në vendin tuaj.
- Para se ta montoni në mur, sigurohuni që muri është në gjendje të mbajë peshën e SoundBar.

## Gjatësia/diametri i vidës

Në varësi të mënyrës së montimit të SoundBar në mur, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.



- (1) Shponi dy vrima në mur.
- (2) Fiksoni upat dhe vidat në vrima.
- (3) Vareni Soundbar në vida.

# 6 Të dhënat e produktit

## Shënim

- Të dhënat dhe dizajni mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

## Amplifikatori

- Fuqia totale output: 300 W, < 10% THD
- Përgjigja e frekuencës: 45 Hz ~ 20 KHz / -10 dB
- Raporti sinjal-zhurmë: > 95 dB (CCIR) / (Vlerësimi A)
- Shtrembërimi harmonik total: < 1%

## Bluetooth /Wireless

- Profili i Bluetooth: A2DP, AVRCP
- Versioni i Bluetooth: 4.2 + EDR
- Banda e frekuencës/Fuqia output: 2402 MHz ~ 2480 MHz/6 ± 2 dBm

## Njësia kryesore

- Furnizimi me energji: 100-240 V~ 50/60 Hz
- Impedanca e bokseve: 6 Ω x 2 +6 Ω x 2
- Përmasat (Gje x The x La): 800 x 95 x 64,7 mm
- Peshë: 2,27 KG
- Temperatura e punimit: 0°C - 40°C

## Subwoofer

- Furnizimi me energji: 100-240 V~ 50/60 Hz
- Impedanca e boksit: 2 Ω
- Përmasat (Gje x The x La): 190 x 280 x 380 mm
- Peshë: 7,57 kg

## Konsumi i energjisë

- Konsumi i energjisë për Soundbar: 84 W
- Konsumi i energjisë për Subwoofer: 117 W
- Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje: < 2 W

## Telekomanda

- Distanca/Këndi: 6 m/30°
- Lloji i baterisë: CR2025

## Formati audio që mbështetet

### HDMI ARC

- Dolby Digital, Dolby Digital Plus, LPCM 2ch

### OPTICAL

- Dolby Digital, LPCM 2ch

### BLUETOOTH

- SBC

### USB

- MP3, WMA, WAV, OGG, FLAC

## Shënim

- Pajisja mund të mos jetë në gjendje t'i dekodojë të gjitha formatet dixhitale audio nga burimi i hyrjes. Në këtë rast, pajisja do të heshtet. Ky nuk është defekt. Sigurohuni që konfigurimi audio i burimit të hyrjes (p.sh. televizor, konsol lojërash, aparat DVD, etj.) të vendoset në PCM, Dolby Digital ose Dolby Digital Plus (Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes burim për hollësi lidhur me konfigurimin e audios) me hyrjen OPTICAL / HDMI.



# 7 Zgjidhja e problemeve



## Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse keni probleme me përdorimin e produktit, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkoni servis.

Nëse ende keni problem, kërkoni ndihmë në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

---

## Njësia kryesore

### Butonat në Soundbar nuk punojnë.

- Shkëputeni Soundbar nga energjia për pak minuta, më pas lidheni përsëri.

---

## Zëri

### Nga Soundbar nuk del zë.

- Lidhni kabullin e audios nga SoundBar në televizor ose në pajisjet e tjera.
- Rivendosni konfigurimet e fabrikës në SoundBar.
- Zgjidhni hyrjen e duhur të audios në telekomandë.
- Sigurohuni që Soundbar nuk është i heshtur.

### Tingulli është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet SoundBar; që televizori nuk është heshtur.

---

## Bluetooth

### Pajisja nuk mund të lidhet me Soundbar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për Soundbar.
- Nuk keni aktivizuar funksionin Bluetooth në pajisje. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të parë se si ta aktivizoni funksionin.
- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidheni pajisjen si duhet. (Shikoni operimin e Bluetooth në faqen 13)
- Soundbar është lidhur tashmë me një pajisje tjetër Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, pastaj provoni përsëri.

### Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje Bluetooth është e dobët.

- Sinjali Bluetooth është i dobët. Çojeni pajisjen më pranë Soundbar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe Soundbar.

### Pajisja Bluetooth e lidhur lidhet dhe shkëputet vazhdimisht.

- Sinjali Bluetooth është i dobët. Çojeni pajisjen më pranë Soundbar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe Soundbar.
- Në disa pajisje Bluetooth, lidhja Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht për të kursyer energji. Kjo nuk do të thotë se ka ndonjë defekt me Soundbar.



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

Prodhuar nën licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Dolby Audio, dhe simboli me dy D janë marka tregtare të Dolby Laboratories.

Markat tregtare të adoptuara HDMI, HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing Administrator, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.

Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim. Ju lutemi vizitoni [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support) për përditësimet dhe dokumentet më të fundit. Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

